



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.2.2023

Nr: 39

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 20 JANAR – 23 JANAR 2023**

Sot, më datë 8.2.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT Prefekti i Qarkut Korçë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Bashkia Roskovec, Bashkia Lushnjë, Bashkia Librazhd, Bashkia Elbasan, Bashkia Dimal, Bashkia Cërrik, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Bashkia Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të organeve publike për periudhën 20 janar deri më 23 janar 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 8.2.2023 Nr: 39
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 20 janar – 23 janar 2023”

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 20 janar deri 23 janar 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 45 aktivitete. Nga verifikimi paraprak, 38 aktivitete nga 17 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Në datë 28.1.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve me shkresë, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkëljes, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 1.2.2023, ora 10:30. Palët e interesuara depozituan pranë KQZ pretendimet e tyre si vijon:

1. Prefekti i Qarkut Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet "Tryezë diskutimi", raportuar në datë 23.1.2023 dhe me datë zhvillimi 27.1.2023,
 - Aktivitet "Inspektim i ecurisë së punimeve të projektit që po zbatohet në Drilon", raportuar në datë 23.1.2023 dhe me datë zhvillimi 27.1.2023.

Prefekti i Qarkut Korçë, nëpërmjet email-it të datës 31.1.2023 dhe shkresës me nr. 107/1 prot, datë 30.1.2023, ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *"Aktivitetet e sipërcituara janë raportuar në datën 23 janar duke llogaritur gabim datën e zhvillimit të aktivitetit pasi ka përfshirë në afat dhe datën e zhvillimit të aktivitetit. Kjo llogaritje e pasaktë nuk ka qenë e qëllimshme sipas tij ka ardhur për shkak të kuptuarit gabim të dispozitës".*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Prefekti i Qarkut Korçë nuk ka pasur si qëllim shmangien e afatit ligjor kur ka raportuar aktivitetet. Moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 (pesë) ditor është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 6 (gjashtë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet "Tryeze diskutimi për Ekonominë Qarkulluese", raportuar në datë 20.1.2023 dhe me datë zhvillimi 24.1.2023,
 - Aktivitet "Mbjellje pemësh në bashkinë Librazhd", raportuar në datë 21.1.2023 dhe me datë zhvillimi 24.1.2023,
 - Aktivitet "Inspektim i Qendrës së Vizitorëve në Pogradec", raportuar në datë 21.1.2023 dhe me datë zhvillimi 24.1.2023,
 - Aktivitet "Takim me Tour Operatorë", raportuar më datë 21.1.2023 dhe me datë zhvillimi 25.1.2023,

- Aktivitet “Vizitë/Inspektim në Drilon”, raportuar në datë 21.1.2023 dhe me datë zhvillimi 24.1.2023,
- Aktivitet “Takim informues”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe me datë zhvillimi 27.1.2023.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me shkresën nr. 699/1 prot, datë 31.1.2023 dhe email-in e datës 29.1.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Fillimisht nga ana e saj nuk ka qenë e mundur aksesimi në ndërfaqe për shkak të problemeve teknike, të cilat i vërteton me 2 email-e të dërguara pranë KQZ-së. Më pas ka vijuar raportimi i aktiviteteve”*.

Aktiviteti me temë “Mbjellje pemësh”, i cili është raportuar më datë 21.1.2023 nuk është zhvilluar si veprimtari. Për sa i përket 5 aktiviteteve të tjerë ka qenë e pamundur të raportohen më parë pasi kanë qenë të pa planifikuara paraprakisht në agjendën e ministrit”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura, aktiviteti temë “Mbjellje pemësh”, nuk është zhvilluar. Vlerësojmë se në këtë rast nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative, për aq kohë sa veprimtaria nuk është zhvilluar. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka pasur si qëllim shmangien e afatit ligjor kur ka raportuar aktivitetet, llogaritja e pasaktë ka ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të saj.

3. Ministria e Drejtësisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet me objekt “Pritja e Raportueses për Shqipërinë në Parlamentin Europian, zj. Isabel Santos”, raportuar në datë 23.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.01.2023.

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet shkresës nr. 620/1 prot, datë 2.2.2023 dhe email-it të datës 2.2.2023, ka dërguar pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Takimi i Ministrit të Drejtësisë me zyrën e Delegacionit të BE-së, ka qenë i pa planifikuar më parë dhe se kërkesa e tyre ka ardhur në datën e raportimit, pra datën 23 janar 2023. Gjithashtu raportimi është bërë me vetëm 1 ditë vonesë, pra në datën 23 janar dhe aktiviteti do të zhvillohej në datën 27 janar”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi vlerësoi si shkaqe të justifikuara pretendimet e Ministrisë së Drejtësisë, vlerësoi se raportimi me 1 ditë vonesë nuk ka ardhur për shkak të vullnetit të saj.

4. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Prezantim i drejtorit, Z. Gjergj Prevazi, me stafin”, raportuar në datë 20.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.01.2023,
- Aktivitet ceremoni gala “Për ndarje çmimesh për vlerësimin e më të mirëve të sipërmarrjes për vitin 2022”, raportuar në datë 23.01.2023 dhe datë zhvillimi 25.01.2023,

- Aktivitet “Mbrëmje kushtuar përkujtimit të Holokaustit”, raportuar në datë 23.01.2023 dhe datë zhvillimi 26.01.2023.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ për të paraqitur pretendimet, Ministria e Kulturës, nëpërmjet shkresës nr. 419/1 prot., datë 31.1.2023 dhe email-it të datës 31.1.2023, prezentë edhe në seancën publike, ka paraqitur pretendimet e saj për aktivitetet e sipërcituara të cilat janë raportuar jashtë afatit për arsyet e renditura si më poshtë vijon:

- *2 prej aktiviteteteve “Ceremonia Gala CCIT Awards” dhe “Mbrëmja kushtuar përkujtimit të Holokaustit” nuk janë veprimtari me karakter publik të planifikuara dhe të organizuara nga Ministria e Kulturës dhe se prezenca e ministres në këto aktivitete ka qenë me statusin e të ftuarit. Afati i njoftimit ka qenë i pamundur më parë për shkak të momentit të marrjes së ftesës përkatëse.*
- *Aktiviteti “Prezantim i Drejtorit të ri të Teatrit Eksperimental”, është kryer në kuadër të organizimit të brendshëm të ministrisë dhe se data e aktivitetit është bërë duke u bazuar në prioritetet dhe agjendën e ministrit.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, Ministria e Kulturës nuk ka pasur detyrimin ligjor të raportojë për 2 aktivitetet për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për sa i përket aktivitetit të tretë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se nisur nga tematika e veprimtarisë së raportuar nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka veprimtaria.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Takim informues me nxënësit e klasave të VIII dhe IX, me qëllim që të njihen me funksionet, detyrat, ambientet e DPSHTRR-së”, raportuar në datë 23.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.01.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. 1828/1 prot., datë 30.1.2023, ka dërguar pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti i sipërcituar është raportuar në datën 23 janar, duke llogaritur gabim datën e zhvillimit të aktivitetit. Kjo llogaritje e pasaktë sipas tij, ka ardhur për shkak të kuptuarit gabim të dispozitës. Gjithashtu deklaroi se institucioni që ai drejton nuk ka qenë organizatori i aktivitetit, por vetëm ka vënë në dispozicion ambientet në kuadër të aktivitetit “Open Days”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor nuk ka pasur si qëllim shmangien e afatit ligjor kur ka raportuar 4 ditë para zhvillimit të aktivitetit por kjo ka ardhur për shkak të llogaritjes së pasaktë të afatit ligjor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka qenë në pamundësi për të përmbushur afatin ligjor për të raportuar këtë aktivitet, për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve

6. Bashkia Roskovec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika, 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim i punimeve në rrugën “Qani Kapo”, Jagodinë, Roskovec”, raportuar në datë 20.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.01.2023,
- Aktivitet “Inspektim në objektin rikonstruksion i rrugës “Shahollarët”, Roskovec”, raportuar në datë 20.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.01.2023.

Bashkia Roskovec, nëpërmjet shkresës me nr. 630/1 prot., datë 1.2.2023 dhe email-it të datës 31.1.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: *“aktivitetet e sipërcituara janë anuluar menjëherë pasi ishte konstatuar prej saj mos raportimi në afat. Gjithashtu, ajo nuk ka mundur të fshijë ose anulojë këto aktivitete pasi sipas saj sistemi nuk e ka fshirjen si opsion”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vëren se aktivitetet janë anuluar për shkak se nuk janë raportuar brenda afatit ligjor. Duke qenë se aktivitetet janë anuluar paraprakisht, atëherë nuk mund të ketë edhe kryerje të kundërvajtjeve administrative për mosraportimin e këtyre aktiviteteve.

7. Bashkia Lushnjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll punimesh në fshatin Barbullinje, Njësia Administrative Fier-Shegan”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.01.2023.

Bashkia Lushnjë, nëpërmjet shkresës nr. 847/1 prot., datë 31.1.2023 dhe email-it të datës 31.1.2023, ka paraqitur pretendimet e saj si dhe i ka parashtruar ato në seancën publike ku ka sqaruar se: *“aktiviteti i sipërcituar është raportuar në datën 21 janar duke llogaritur gabim edhe datën e zhvillimit të aktivitetit. Kjo llogaritje e pasaktë, sipas saj ka ardhur për shkak të*

kuptuarit gabim të dispozitës. Ajo shprehet se më pas të gjitha aktivitetet janë raportuar në kohë sipas përlogaritjes së saktë të afatit ligjor.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoi se moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

8. Bashkia Librazhd ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 23.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 26.01.2023.

Bashkia Librazhd, nëpërmjet shkresës nr. 570/1 prot., datë 31.1.2023, ka paraqitur pretendimet e saj si dhe i ka parashtruar ato në seancën publike ku ka sqaruar se: *“aktiviteti i sipërcituar është raportuar përtej afatit për shkak të gabimit njerëzor gjatë hedhjes së datës së aktivitetit. Pas konstatimit të gabimit ai nuk ka mundur të fshijë ose anulojë këtë aktivitet pasi sipas tij sistemi nuk e ka fshirjen si opsion”.*

Konstatohet se bashkia Librazhd ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

9. Bashkia Elbasan ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ftesë nga Myftinia Elbasan”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.01.2023.

Bashkia Elbasan, nëpërmjet shkresës nr. 649/1 prot., datë 30.1.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“aktiviteti i sipërcituar ka qenë i organizuar nga Këshilli i Bashkisë në bashkëpunim me myftininë e Elbasanit dhe se ai ka qenë i ftuar në këtë takim. Pavarësisht kësaj, për të qenë korrekt me detyrimet ligjore, ai ka raportuar takimin me një ditë vonesë”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, Bashkia Elbasan nuk ka pasur detyrimin ligjor të raportojë për aktivitetin për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose

ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

10. Bashkia Dimal ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ndërgjegjësues/informues”, raportuar në datë 23.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.1.2023.

Bashkia Dimal ka qenë e pranishme në seancë publike dhe ka parashtruar pretendimet duke sqaruar se: *“aktiviteti i sipërcituar është raportuar në datën 23 janar duke llogaritur gabim edhe datën e zhvillimit të aktivitetit. Kjo llogaritje e pa saktë, sipas saj ka ardhur për shkak të kuptuarit gabim të dispozitës”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se bashkia Dimal nuk ka pasur si qëllim shmangien e afatit ligjor kur ka raportuar aktivitetin e cituar në këtë vendim. Llogaritja e pasaktë në raportimin e aktivitetit nga ana e saj ka ardhur për shkak të kuptimit gabim të dispozitës.

11. Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 5 (pesë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Mbjellja e pemëve në bashkëpunim me komunitetin në fshatin Gostimë, NJ.A Gostimë”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 21.01.2023,
- Aktivitet “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike fshati Malasej, NJ.A Gostimë”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 22.01.2023,
- Aktivitet “Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike, Fshati Gostimë NJ.A Gostimë”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 23.01.2023,
- Aktivitet “Inspektim në banesën e rikonstruktuar në fshatin Klos për familjet në nevojë”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.01.2023,
- Aktivitet “Inagurim i Shkollës “Beqir Sade” Selitë, pas rikonstruksionit”, raportuar në datë 21.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 25.01.2023.

Bashkia Cërrik ka paraqitur pretendimet e saj nëpërmjet shkresës nr. 307/1 prot., datë 30.1.2023 dhe ka sqaruar se: *“aktivitetet e raportuara, në datën 16.01.2023 janë raportuar pranë KQZ-së me shkresë. Kjo për shkak se institucioni i tyre nuk ka pasur një llogari të hapur në ndërfaqen e raportimit. Më pas në datën 21.01.2023 ka mundur të identifikohet si përdorues pasi në atë datë i është krijuar edhe llogaria në ndërfaqe. Në po atë datë ka vepruar duke hedhur të pesta aktivitetet e raportuara më parë nëpërmjet shkresës”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, Bashkia Cërrik nuk ka pasur si qëllim shmangien e afatit ligjor kur ka raportuar 3 ditë para zhvillimit të aktiviteteve, por ka ngarkuar aktivitetet për shkak se këtë datë i është krijuar llogaria e përdoruesit në ndërfaqe. Gjithashtu, nëpërmjet shkresës Bashkia Cërrik i ka raportuar aktivitetet e sipërcituar brenda afatit ligjor.

12. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti me objekt: “Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit në rajonin e Vlorës”, raportuar në datë 20.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 20.01.2023.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka paraqitur pretendimet me email-in e datës 30.1.2023 dhe ka sqaruar se: *“aktiviteti i sipërcituar është raportuar fillimisht me shkresë dërguar pranë KQZ-së në datën 17.01.2023. Sipas saj dhe raportimit me shkresë, ky aktivitet do të zhvillohej në datën 26.01.2023. Gjithashtu, më pas u krye edhe raportimi i të njëjtit aktivitet nëpërmjet ndërfaqes, por gabimisht, është vendosur data 20 janar edhe në rubrikën e datës së raportimit edhe në atë të zhvillimit të aktivitetit. Aktiviteti i raportuar është zhvilluar vetëm në datën 26.01.2023”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, aktiviteti është raportuar në afat nëpërmjet shkresës dhe se raportimi i pasaktë nëpërmjet ndërfaqes, ka qenë një lapsus që është kryer në sistem në hedhjen e të dhënave.

13. Autoriteti i Mediave Audiovizive ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Tryezë këshillimore, pjesë e vijimit të procesit të këshillimit publik për Projektkodin e rishikuar të Transmetimit, filluar në Qershor 2022”, raportuar në datë 23.01.2023 dhe datë zhvillimi 26.01.2023.

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka paraqitur pretendimet me shkresën nr. 622/1 prot., datë 31.1.2023 dhe ka sqaruar se: *“aktiviteti i sipërcituar është raportuar fillimisht në datën 17 janar për tu zhvilluar në po të njëjtën datë 26 janar por në një tjetër orë. Në datën 23 janar ka tentuar në sistem të ndryshojë orën e zhvillimit të veprimtarisë. Duke qenë se sistemi nuk e lejon opsionin e ndryshimit të orës së aktivitetit ajo e ka rihedhur edhe një herë të njëjtin aktivitet si raportim i ri. Qëllimi i vetëm i rihedhjes së aktivitetit ka qenë zbatimi me korrektesë i dispozitës ligjore”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vëren se aktivitetet janë anuluar për shkak se nuk janë raportuar brenda afatit ligjor. Duke qenë se aktivitetet janë anuluar paraprakisht, atëherë nuk mund të ketë edhe kryerje të kundërvajtjeve administrative për mosraportimin e këtyre aktiviteteve.

14. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet me objekt: “Tryezë diskutimi-Finalizimi i zhvillimit të kornizave të një Strategjie Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, e cila përfshin hartimin e qëllimeve të politikës, identifikimin e iniciativave mbështetëse për secilin qëllim, identifikimin e aktorëve për secilën iniciativë dhe rekomandimet për sfidat dhe tejkalimin e tyre për implementimin e aktiviteteve”, raportuar në datë 20.01.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 24.01.2023.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike ka paraqitur pretendimet e tij nëpërmjet email-it të datës 30.1.2023 dhe ka sqaruar se: *“fillimisht ka qenë e pamundur aksesimi i llogarisë. Për këtë qëllim janë dërguar tre e-maile, përkatësisht në datat 16, 17 dhe 18 janar 2023. Pas komunikimit telefonik me përfaqësues të KQZ-së u kuptua se komunikimi përfundonte në rubrikën junk të e-malit. Menjëherë në datën 20 janar, kur është bërë e mundur aksesimi i llogarisë është raportuar aktiviteti i cili do të zhvillohej në datat 24, 25 dhe 26 janar”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se, problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

15. Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve, 6 (gjashtë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Mbjellje pemësh në Prush”, raportuar në datë 20.1.2023 dhe me datë zhvillimi 21.1.2023;
- Në datën 20.1.2023 në ndërfaqen e raportimeve, janë raportuar 5 aktivitete me datë zhvillimi 24.1.2023:
 - Aktivitet me objekt “Inagurim shkollë “Kico Bushi dhe “Sevasti Qirjazi”;
 - Aktivitet me objekt “Takim me administratorët e shkollave”;
 - Aktivitet me objekt “Takim me shoqatat sportive të shkollave”;
 - Aktivitet me objekt “Takim me drejtorët dhe mësuesit e shkollave”;
 - Aktivitet me objekt “Event i madh me nxënësit me rezultate të shkëlqyera”;

Bashkia Tiranë ka paraqitur pretendimet e saj me shkresën nr. 3970/1 prot., datë 31.1.2023 dhe ka sqaruar se: *“aktiviteti i parë me temë “Mbjellje pemësh në Prush”, është raportuar duke shënuar gabim datën e zhvillimit të tij. Gjithashtu sqaron se ky aktivitet nuk është zhvilluar. Në lidhje me 5 aktivitetet e tjera parashtron se ato janë raportuar duke llogaritur edhe datën e zhvillimit të tyre. Kjo llogaritje e pasaktë ka ardhur për shkak të kuptuarit gabim të dispozitës”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vëren se, aktiviteti i parë nuk është zhvilluar. Duke qenë se aktiviteti nuk është zhvilluar në datën që është raportuar gabim, atëherë nuk mund të ketë edhe kryerje të kundërvajtjeve administrative për mosraportimin e këtij aktiviteti.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerësoi se, moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkaku që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit, është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit, e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se bashkia Tiranë ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim, deri në këtë periudhë shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012, “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Pushimin e procedimin administrativ ndaj:

- a) Prefektit të Qarkut Korçë,
- b) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit,
- c) Ministrisë së Drejtësisë,
- ç) Ministrisë së Kulturës;
- d) Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor,
- dh) Bashkisë Roskovec,
- e) Bashkisë Lushnjë,
- ë) Bashkisë Librazhd,
- f) Bashkisë Elbasan,
- g) Bashkisë Dimal,

Data: 8.2.2023 Nr: 39
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive publike të disa institucioneve, për periudhën 20 janar – 23 janar 2023”

- gj) Bashkisë Cërrrik,
 - h) Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore,
 - i) Autoritetit të Mediave Audiovizive,
 - j) Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike,
 - k) Bashkisë Tiranë.
2. Tërheqje vëmendje ndaj organeve publike që të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e përcaktimeve të parashikuara në nenin 92 të Kodit Zgjedhor dhe në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.
 3. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI